

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komoru medicinskih sestera, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Prot. no. 136	Nr. i faq. 4	Data: 24.09.2026
Urroj. prot.	Br. str.	Date: 383 44 981 529 fetahufaton@gmail.com
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		

AVOKAT: FATON FETAHU

Rr. "Bashkim Fehmiu", nr.32/I, Arbëria III, Prishtinë

Date: 383 44 981 529 fetahufaton@gmail.com

KONTRATË PËR SHËRBIME JURIDIKE

E lidhur në Prishtinë, më datë 24 shkurt 2026, ndërmjet:

- **Faton Fetahu Avokat** me nr. të regjistrimit në OAK: 2118/2021, me numër unik identifikues të biznesit në ARBK: 811863994, me adresë të zyrës: Rr. "Bashkim Fehmiu", nr.32/I, Arbëria III, Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër personal 1232802126, në tekstin në vijim referuar si "**Ofruesi i shërbimeve**"

Dhe

- **Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës**, me adresë Rr. "Holger Pedersen" Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, të cilën e përfaqëson Kryetarja e Odës, znj. Nexhmije Gori, në tekstin në vijim referuar si "**Pranuesi i shërbimeve**"

Bashkërisht, të referuar si "**Palët**"

Neni 1 Qëllimi

Kjo kontratë rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet palëve lidhur me ofrimin e shërbimeve profesionale juridike nga Ofruesi i Shërbimeve për Pranuesin e Shërbimeve dhe për anëtarët e tij. Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, çdo marrëveshje e mëparshme ndërmjet palëve për të njëjtën lëndë konsiderohet e zgjidhur/shfuqizuar.

Neni 2 Objekti i kontratës

1. Ofruesi i Shërbimeve merr përsipër të ofrojë shërbime juridike sipas parimit *rast për rast*, duke përfshirë përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave ligjore të Odës para gjykatave të të gjitha niveleve, prokurorive, organeve të administratës publike qendrore dhe lokale, organeve disiplinore dhe çdo autoriteti tjetër kompetent. Përfaqësimi përfshin ndërmarrjen e të gjitha veprimeve procedurale, ushtrimin dhe tërheqjen e mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, si dhe përfaqësimin në procedura të ndërmjetësimit, ujdj gjyqësore dhe jashtëgjyqësore.
2. Në kuadër të kësaj kontrate, Ofruesi i Shërbimeve do të ushtrojë përfaqësim profesional për anëtarët e Odës në rastet e ushtrimit të padive për dëmshpërblim për shkak të shkeljes së nderit, cenimit të dinjitetit dhe dëmtimit të integritetit profesional. Kjo përfshin përgatitjen e padive, përfaqësimin në procedura civile për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, si dhe ndërmarrjen e çdo veprimi të nevojshëm për mbrojtjen efektive të reputacionit profesional të anëtarëve.

AVOKAT: FATON FETAHU
Rr. "Bashkim Fehmiu", nr.32/I, Arbëria III, Prishtinë
+ 383 44 981 529 fetahufaton@gmail.com

3. Ofruesi i Shërbimeve do të ofrojë mbrojtje ligjore në të gjitha çështjet që burojnë nga marrëdhënia e punës, përfshirë por pa u kufizuar në kontestet lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës, procedurat disiplinore, mosrespektimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, mos pagesën e pagës, diskriminimin dhe çdo shkelje tjetër të të drejtave të garantuara me legjislacionin e punës në fuqi.
4. Shërbimet juridike do të përfshijnë gjithashtu përfaqësimin në procedura administrative dhe gjyqësore që lidhen me fitimin e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, njohjen e stazhit të punës dhe çdo kontest tjetër me autoritetet kompetente pensionale.
5. Ofruesi i Shërbimeve do të përfaqësojë anëtarët e Odës edhe në kontestet që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave të konkurseve publike, duke përfshirë ankesat ndaj rezultateve të konkurseve, shkeljet procedurale në procesin e rekrutimit dhe kontestet administrative apo gjyqësore që rrjedhin nga këto procedura.

Neni 3
Mënyra e angazhimit

1. Ofruesi i shërbimeve do t'i ofroj Odës së infermiereve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës, shërbime profesionale juridike në përputhje me këtë Kontratë; Do ta informojnë kryetaren/in respektiv sipas kërkesës së tij lidhur me zhvillimet që lidhen me kontestet përkatëse si dhe lidhur me çështjet për të cilat ofrohen shërbimet sipas nenit I të kësaj kontrate.
2. Pranuesi i shërbimeve, do të njoftoj avokatin për secilin rast në të cilin kërkon shërbime dhe për të njëjtin siguron dërgimin e shkresave të lëndës brenda një afati sa më të shpejtë kohor, qoftë në mënyrë fizike në adresën e zyrës së tij ose në mënyrë elektronike përmes emailit përkatës. Njoftimi për avokatin në çdo rast bëhet me shkrim (përmes emailit) nga ana e zyrtarit përgjegjës të Zyrës Ligjore të pranuesit të shërbimeve apo personit tjetër të autorizuar, ndërsa në raste përjashtimore dhe në rrethana urgjente që e pamundësojnë njoftimin me shkrim, njoftimi i tillë mund të bëhet edhe verbalisht ose përmes telefonit.
3. Ofruesi i shërbimeve, për të gjitha veprimet procedurale që i kryen në emër dhe për llogari të Odës së infermiereve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës apo të anëtarit të saj, përpilon faturën e shpenzimeve e cila bazohet në Rregulloren për Tarifën e Avokatëve (në fuqi) të Odës së Avokatëve të Kosovës. Secila faturë konkrete përmban llojin e veprimit procedural të kryer, numrin e lëndës, datën e kryerjes së shërbimit dhe datën e kryerjes së faturimit, shumën e pagesës, të dhënat e llogarisë bankare, vulën dhe nënshkrimin e avokatit.

Neni 4
Tarifat dhe shpenzimet

AVOKAT: FATON FETAHU
Rr. "Bashkim Fehmiu", nr.32/I, Arbëria III, Prishtinë
+ 383 44 981 529 fetahufaton@gmail.com

1. Të gjitha shërbimet juridike që ofrohen në bazë të kësaj kontrate do të faturohen në përputhje me Rregulloren për Tarifat e Avokatisë, në fuqi në momentin e kryerjes së shërbimit. Çdo faturë do të përmbajë përshkrimin e veprimit procedural të kryer, numrin e lëndës, datën e kryerjes së shërbimit, bazën tarifore sipas rregullores, shumën e pagesës, të dhënat bankare si dhe nënshkrimin dhe vulën e avokatit.
2. Përveç tarifës profesionale të avokatit, Pranuesi i Shërbimeve merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet procedurale që lidhen me rastin konkret, përfshirë taksat gjyqësore, shpenzimet e ekspertizave, përkthimet, shpenzimet noteriale dhe çdo shpenzim tjetër të domosdoshëm për zhvillimin e procedurës.

Neni 5
Faturimi, pagesat dhe njoftimet

1. Për shumën e pranuar nga ofruesi i shërbimeve lidhur me shërbimet që do t'i ofrohen, por edhe çdo pagesë tjetër, pranuesit të shërbimeve do t'i dërgohet fatura.
2. Pagesa do të ekzekutohet në afat ditor prej 3 deri në 10 ditësh pas dërgimit të faturës, për veprimin e kryer. Pagesa nga neni 3 i kësaj kontrate, bëhet në llogarinë bankare të biznesit të ofruesit të shërbimeve **TEB.SH.A** me numër: **20-11-0002009097-38**
3. Çdo njoftim zyrtar që duhet të jepet në bazë të kësaj kontrate, duke përfshirë çdo problem dhe ankesë në lidhje me ofruesin e shërbimeve ose faturat, duhet të bëhet me shkrim dhe do të dorëzohet me dorë, ose të dërgohet në email adresat vijuese:
 - 3.1. Për pranuesin e shërbimeve, emaili i Kryetarit të Odës dhe/ose zyrtarit përgjegjës të Zyrës Ligjore të Odës apo zyrtarit tjetër të autorizuar nga Oda;
 - 3.2. Për ofruesin e shërbimeve: fetahufaton@gmail.com;

Neni 6
Konfidencialiteti

Ofruesi i Shërbimeve obligohet të ruajë sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të gjitha informacioneve që lidhen me rastet e trajtuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e etikës profesionale.

Neni 7
Kohëzgjatja dhe ndërprerja

1. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe lidhet për afat të pacaktuar.
2. Secila palë ka të drejtë ta ndërpresë kontratën me njoftim me shkrim, tridhjetë ditë përpara datës së ndërprerjes.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo kontratë ta zgjidhin në mënyrë miqësore. Në rast se nuk arrihet marrëveshje, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 9
Dispozita përfundimtare

1. Çdo ndryshim apo plotësim i kësaj kontrate bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
2. Kontrata përpilohet në dy ekzemplarë origjinalë, nga një për secilën palë.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët.

Për Odën Odës së infermjereve, mamive dhe
profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Nexhmije Gori, Kryetare




Për ofruesin e shërbimeve:

AVOKAT-LAWYER
FATON FETAHU
Tel. 044/981-529
E-mail: fetahufaton@gmail.com

Av. Faton FETAHU
